
AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “Kron Construction”sh.p.k

Ne Tiranë, sot me datë **03.06.2021**, ne të nënshkruarit më poshtë:

- **z.Armando Pajtoni**, atësia Shaban dhe amësia Fejzie, i datëlindjes 11 Gusht 1979, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga “Gjergj Legisi”, banesë private, Nr. 11, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 037163501 dhe numër personal H90811058K.

- **z.Arben Memo**, atësia Beqo dhe amësia Nimete, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje, me date 08.07.1978, madhor me zotësi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr 035195389 dhe nr personal H80708177D .

Ne baze e per zbatim te ligjit nr 9901 date 14.04.2008”Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “i ndryshuar dhe legjislacionit te Republikes se Shqiperise ne pergjithesi, vendosem si vijon:

Kreu I

Emertimi, Selia,objekti,afati i shoqerise

Neni 1

Ne te nenshkruarit Armando Pajtoni dhe Arben Memo, deshirojme permes ketij akti te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga akti i themelimit,statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet”**Kron Construction**”shpk.

Neni 3

Selia Qendore e Shoqërisë është në adresen: Tirane,Kashar, Lagjja Fushe Mezes, Autostrada Tirane Durres km 1, Qendra Pajtoni Bussines Center,Kati 4.

Shoqëria mund te hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera,brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra ne vende të ndryshme, pervec selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

Neni 4

Objekti i shoqërisë do të konsistoje ne :

Kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga legjislacioni shqiptar. Prodhim dhe tregtim të materialeve të ndertimit. Ndërtime civile e industriale, restaurimi, karpentiere, impiante teknologjike dhe të vecanta, punime topogjeodezike,punime germime dheu, armature hekur, veshje fasadash, si edhe cdo kryerje punimesh ndertimi te cdo kategorie etj,investime ne projekte te ndryshme.Shoqeria mund, në rrugë të instrumentalizuar, të kryejë cdo operacion tregtar,ndërtimor e imobiliar .Prodhim dhe tregtim betoni,materiale interte, shitje me shumice e pakice materiale ndertimi, transport lende te para ,shitblerje pasuri e paluajtshme ,projektim dhe zbatim i objekteve ndertimore . Aktivitete në fushën e ndertimit,ndertime civile, rikonstruksione, mirembajtje ndertesash. Tregtim i artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice e pakice.

Shoqeria mund të kryejë cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar kohe.

Kreu II

Neni 6

Kapitali

6.1. Kapitali themeltar I shoqërisë është 100 leke (njëqind leke) I ndare në 2 kuota, sipas pjesëmarrjes së themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet si më poshtë:

z - Armando Pajtoni, atësia Shaban dhe amësia Fejzie, i datëlindjes 11 Gusht 1979, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: rruga "Gjergj Legisi", banesë private, Nr. 11, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 037163501 dhe numër personal H90811058K, zoteron **1 kuota** me pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë **prej 90%** (nëntëdhjetë për qind).

- **z. Arben Memo**, atësia Beqo dhe amësia Nimete, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë, me datë 08.07.1978, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr 035195389 dhe nr personal H80708177D, zoteron **1 kuota** me pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë **prej 10%** (dhjetë për qind).

6.2. Kuotat janë të zakonshme dhe të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe Statut. Kuotat e kapitalit shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

6.3. Ortaku mban përgjegjësi të kufizuar në marrëdhëniet juridike – civile me të tretet, përgjegjësi që kufizohet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar prej tij.

Neni 7

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale dhe perfaqësi Brenda dhe jashtë vendit, konform ligjit shqiptar.

Kreu III

Organet e shoqërisë

Neni 9

9.1. Shoqëria është e organizuar në organet e saj drejtuese të cilat janë:

1-Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve

2-Administratori

9.2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me Statutin vendime të cilat janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

9.3. Kompetencat e Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve, janë si më poshtë:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10

10.1. Organi vendimarrës i shoqërisë, Asambleja e Ortakeve emeron me shumicë të thjeshtë një ose me shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë.

10.2. Afati i emerimit është 5 vjet me të drejtë ripërteritje. Emerimi i administratorit prodhon efekte vetëm pas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

10.3. Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të marre me shumicë të thjeshtë nga Asambleja.

10.4. Administrator i shoqërisë emerohet z.Arben Memo, atesia Beqo dhe amesia Nimete, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë, me datë 08.07.1978, madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr 035195389 dhe nr personal H80708177D, madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

Emerohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje. Administratori mund të shkarkohet me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve.

Kreu IV

Neni 11

Prishja dhe Likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
- c) ne rast se objekti behet I porealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe qe bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare
- d) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit
- e) ne raste te tjera te parashikuara ne ligj
- f) per cdo shkak tjetër te vendosur nga Asambleja e Ortakeve

Neni 12

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

12.1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", I ndyshuar.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji lex specialis në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarreveshjeve


Për zgjidhjen e mosmarreveshjeve që kanë të bëjnë me interpretimin e këtij akti themelimi apo ato që mund të lindin midis ortakëve apo ortakëve dhe të tretëve, kompetente për këto do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtit ligjor.

Akti I themelimit pasi u lexua dhe u kuptua nga palet nënshkruhet prej tyre me vullnet të lire, të plote e të pavesuar.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

z.Armando Pajtoni



z.Arben Memo

